

UDC 339.56(497.7):339.54:061.1 (100)

Fisnik MUÇA¹

**PËRFITIMET DHE KOSTOT NGA ANËTARËSIMI NË ORGANIZATËN BOTËRORE
TË TREGTISË – RASTI I MAQEDONISË**

**ПРИДОБИВКИТЕ И ТРОШОЦИТЕ ОД ЧЛЕНСТВОТО НА СВЕТСКАТА
ТРГОВСКА ОРГАНИЗАЦИЈА- СЛУЧАЈОТ НА МАКЕДОНИЈА**

**BENEFITS AND COSTS FROM THE MEMBERSHIP IN THE WORLD TRADE
ORGANIZATION – THE CASE OF MACEDONIA**

Abstract

Despite the states which try to implement protectionist policies in terms of foreign trade, the involvement of the great powers and the interest of developing countries is the liberalization of trade through the elimination of non-customs barriers and the gradual reduction of customs duties. This research paper points out the benefits and costs of Macedonia from membership in World Trade Organization (WTO). At first, are described the rules and principles of the WTO, the misunderstandings which are set and the importance of this organization in the international arena in the field of trade. It is analyzed the report of the WTO Secretariat issued 10 years after Macedonia's membership in the WTO, which explain the current situation of trade and economic policies of the country. Based on the statistics of the Statistical Office of Macedonia and the results of interviews conducted by competent persons in the field of multilateral trade in Macedonia, we came to a conclusion that which are some of the costs and benefits of Macedonia from the membership. Beneficiaries of membership are categorized into three levels: the state, companies and consumers. Minimum costs which may have affected the government's budget, compared to the benefits are almost unimportant.

Key word: Free trade, export-import, Macedonia, WTO, customs

Abstrakt

Edhe përskaaj asaj që shtetet përpiqen të zbatojnë politika proteksioniste sa i takon tregtisë së jashtme, angazhimi i fuqive të mëdha dhe interesi i shteteve në zhvillim është liberalizimi i tregtisë nëpërmjet eliminimit të barrierave jodoganore dhe reduktimit gradual të tarifave doganore. Nëpërmjet këtij punimi hulumtues nxirren në pah përfitimet dhe kostot e Maqedonisë nga anëtarësimi në Organizatën Botërore të Tregtisë(OBT). Fillimisht bëhet një përshkrim i rregullave dhe parimeve të OBT-së, keqkuptimeve të cilat janë paraqitur rreth kësaj organizate dhe rëndësia që ka në skenën ndërkombëtare në fushën e tregtisë. Duke analizuar Raportin e Sekretariatit të OBT-së të lëshuar 10 vite pas anëtarësimit të Maqedonisë në OBT, jepet një sqarim mbi gjendjen aktuale të politikave tregtare dhe ekonomike të vendit. Duke u bazuar në statistikat e Entit Statistikor të Maqedonisë dhe rezultatet e intervistave të realizuara me personat kompetent nga fusha e tregtisë shumëpalëshe në Maqedoni, vijnë në konkludim se cilat kanë qenë disa nga kostot dhe përfitimet e Maqedonisë nga ky anëtarësim. Përfitimet janë kategorizuar në tre nivele dhe atë: shteti, kompanitë dhe konsumatorët. Sa u takon kostove minimale të cilat mund të kenë prekur buxhetin e qeverisë, në krahasim me përfitimet janë pothuajse të parëndësishme.

¹ Doktorant në drejtimin : Shkenca Politike në UEJL, Ministria e Drejtësisë, fisnik.muca@hotmail.com

Fjalët kyçe: Tregti e lirë, eksport-import, Maqedonia, OBT, tarifa doganore

Hyrje

Pavarësisht asaj që edhe sot disa nga shtetet parapëlqejnë të izoloohen nga proceset globalizuese, globalizimi ekonomik është një dukuri që ka prekur pothuajse çdo sferë të jetës. Shtetet duke u integruar në një ekonomi ndërkombëtare dhe duke hapur tregjet e tyre për depërtimin e investimeve të huaja direkte dhe korporatave shumëkombëshe, me kalimin prej një tregtie të izoluar drejt asaj liberale, inkuadrohen në një arenë ndërkombëtare ku përfitojnë nga rregullat dhe parimet të cilat derivohen nga organizatat ndërkombëtare. Përveç përfitimeve në fushën e ekonomisë, tregtisë dhe financave, shtetet nëpërmjet proceseve globalizuese përfitojnë edhe nga inovacionet teknologjike dhe të informacionit, duke qenë kështu gjithmonë në hap me kohën. Shkëmbimet tregtare të mallrave dhe shërbimeve realizohen në tregjet botërore. Shtetet të cilat kanë të zhvilluar tregtinë e jashtme dhe janë konkurrentë në tregjet botërore, kanë rritje ekonomike dhe mirëqenie njerëzore në vendin e tyre. Roli i tregtisë ndërkombëtare është shpërndarja efiçente e burimeve ekonomike të kufizuara, përballë kërkesave dhe nevojave të individëve të cilat janë të pakufizuara, parë nga këndvështrimi ndërkombëtar. Gjithashtu nëpërmjet tregtisë ndërkombëtare mundësohet specializimi i vendeve në prodhimin e mallrave apo shërbimeve. Si rezultat i këtij specializimi, makinat kualitative prodhohen në Gjermani, lodrat plastike dhe tekstili eksportohen nga Kina, njihet në botë kafeja braziliane, e kështu me radhë. Nëse u referohemi treguesve statistikor të tre viteve të fundit, do të konstatojmë që tregtia e mallrave në nivel botëror, ka pasur rritje apo rënie më të madhe se sa GDP-ja në nivel botëror. Tregtia liberale është më e mirë dhe e dobishme se sa kufizimi i saj. Por praktika dëshmon se tregtia ndërkombëtare kufizohet me mjete të ndryshme. Secili vend i botës, zbaton politikën kufizuese me qëllim që të mbrojë ekonominë kombëtare nga konkurrenca e jashtme.

1. Roli dhe rëndësia e OBT-së në liberalizimin e tregtisë ndërkombëtare: përfitimet dhe kostot nga anëtarësimi

Termi tregti e globalizuar për herë të parë paraqitet në Perandorinë Romake, ku Rruga e Mëndafshit u bë njëra ndër rrugët më të gjëra të tregtisë dhe trafik të rënduar. Nëpërmjet kësaj rruge importoheshin mëndafsh, erëza dhe perde nga Kina nëpërmjet Mesopotamisë, kurse drejt Lindjes eksportoheshin fildish, gurë dhe metale të çmuara, përfshirë edhe arin. Edhe pse kjo formë e tregtisë nuk kishte elementet e një tregtie të lirë pasi që romakët vendosnin detyrime doganore dhe taksa në mallrat e importuara, kërkesa për mëndafsh nga gratë romake dhe përfitimet e tregtarëve romakë që merreshin me tregtinë e mallrave të importuar, çoi deri në atë pikë që kjo çështje të diskutoheshin në Senatin Romakë. Nga njëra anë kishim prodhuesit romakë të cilët dëmtoheshin financiarisht nga importet, kurse nga ana tjetër kërkesën për mëndafsh e cila ishte

tepër e madhe.² Qysh prej asaj kohe shihen elementet e një tregtie proteksioniste ku në emër të argumenteve morale kinse veshja e mëndafshit kishte influencë shkatërruese në shoqëri dhe të shpallej i jashtëligjshëm, kurse nga ana tjetër kemi një tentativë për liberalizimin e kësaj tregtie dhe heqjen e barrierave të ndryshme. Sot, me kodifikimin e të drejtës ndërkombëtare dhe themelimin e organizatave ndërkombëtare, rregullimi i çështjeve të tregtisë realizohet nëpërmjet parimeve dhe marrëveshjeve shumëpalëshe në kuadër të organizatave të karakterit ekonomik dhe tregtar. Një organizatë ndërkombëtare e karakterit tregtar e themeluar pas Luftës së Dytë Botërore është edhe Organizata Botërore e Tregtisë (OBT), e cila është një pasardhëse e Marrëveshjes së Përgjithshme për Dogana dhe Tregti (GAAT), por që me Marrëveshjen e Marrakeshit në vitin 1995 kaloi në OBT. OBT-ja jo vetëm që përfshin marrëveshjet shumëpalëshe për liberalizimin e tregtisë së mallrave, por gjithashtu përfshin edhe marrëveshjet për liberalizimin e shërbimeve (GATS) dhe mbrojtjen e pronësisë intelektuale (TRIPS). OBT-ja gjithashtu shërben edhe si një forum negociatash, ku shtetet anëtare shprehin pakënaqësitë dhe paqartësitë në fushën e tregtisë dhe shërbimeve, në këtë mënyrë duke shmangur konfliktet eventuale të cilat mund të paraqiten nga fusha e tregtisë.

Qëllimet kryesore të OBT-së padyshim që mbeten: liberalizimi e tregtisë, rritja e sasisë së prodhimit dhe shërbimeve, hapja e tregjeve për investimet e huaja direkte, përmbushja e nevojave të konsumatorëve, ndihma e vendeve në zhvillim, avancimi i vendeve të zhvilluara, e kështu me radhë. Parimet kryesore në të cilat është i mbështetur sistemi shumëpalësh i OBT-së janë: parimi i tregtisë pa diskriminim (klauzola e kombit më të favorizuar dhe trajtimi nacional), liberalizimi i tregtisë gradualisht nëpërmjet negociatave, parashikueshmëria nëpërmjet detyrimeve dhe transparencës, promovimi i konkurrencës lojale dhe inkurajimi i reformave ekonomike dhe zhvillimit.³ Ajo çka duhet shpjeguar në këtë rast është *tregtia pa diskriminim*. Sipas këtij parimi p.sh. nëse Maqedonia vendos që për një produkt të caktuar që importohet nga Shqipëria të ul tarifën doganore prej 5% në 3%, atëherë këtë duhet ta bëjë edhe ndaj një shteti të tretë anëtar i OBT-së, p.sh. ndaj Bullgarisë. *Trajtimi nacional* nënkupton që çdo produkt i importuar në momentin kur hyn në shtetin amë merr trajtim nacional dhe konsiderohet i njëjtë me produktet vendase, pra duke mos vendosur asnjë taksë shtesë.

*“Secili shtet që lëviz nga tregtia e pavarur te ajo e lirë, mund të përjetojë përfitime në të hyrat reale. Ekzistojnë skemat reale për kompensim me të cilat garantohet se të gjithë anëtarët e një shteti mund të realizojnë përfitim nga tregtia ndërkombëtare”*⁴ Edhe pse shtetet të cilat anëtarësohen në OBT ballafaqohen me kosto dhe sfida gjatë procesit së përgatitjes së Memorandumit të Regjimit të Tregtisë së Jashtme dhe gjatë procesit të negociatave për anëtarësim, shteti anëtar në OBT mund që të përfitojë nga liberalizimi i tregtisë dhe marrëveshjet shumëpalëshe të nënshkruara. Në përgjithësi kostot nga anëtarësimi në OBT kanë të bëjnë me të

² Natalie Goldestein, *Globalization and Free Trade*, Infobase Publishing, New York, 2007, f. 3-4

³ WTO, *Understanding the WTO*, World Trade Organization, Geneva, 2011, f. 10

⁴ Richard E.Caves & Jeffrey A.Frankel & Ronald W.Jones, *Tregtia Botërore dhe Pagesat*, Ars Lamina, Shkup, 2013, f. 37

ardhurat doganore, pasi që tarifrat doganore nga importet janë pjesë përbërëse e buxhetit shtetëror. Një kosto tjetër është edhe konkurrenca nga e cila do të rrezikohen sektorët vendas të cilat prodhojnë të njëjtat produkte, por e gjithë kjo mund që të rregullohet me një plan për mbrojtjen e industrive vendase me kuota të importit të cilat janë të lejuara me parimet dhe rregullat e OBT-së. Kostot e insitucionalizimit, strategjitë dhe reformat e nevojshme, ndryshimet legjislative po ashtu paraqesin kosto shtesë të cilat dalin si rezultat i anëtarësimit në OBT.

Përfitimet ⁵ nga OBT-ja mund të kategorizohen në tre grupe:

- **Përfitimet në nivel ndërkombëtar:** promovimi i paqes në nivel botëror dhe zgjidhja e konflikteve dhe mosmarrëveshjeve nëpërmjet bisedimeve;
- **Përfitimet në nivel të shteteve anëtare dhe qeverive:** tregtia rrit të ardhurat e shtetit, stimulon rritjen ekonomike si dhe mbron qeveritë nga lobimet duke nxitur një qeverisje më të mirë dhe më eficiente;
- **Përfitimet në nivel të konsumatorëve:** tregtia e lirë ul shpenzimet e jetës, mundëson një gamë më të gjerë të produkteve kualitative duke e bërë kështu jetën më të lehtë për të gjithë.

Kundërshtarët e globalizimit dhe liberalizimit të tregtisë kanë nxjerrë në pah shumë pikëpyetje sa i takon regjimit tregtar të OBT-së. Ata thonë që OBT-ja dirigjon politikën e vendeve anëtare duke kërkuar një tregti liberale me çdo kusht, si dhe atë që shtetet e vogla janë të pafuqishme për të thënë fjalën e tyre në këtë organizatë. Duke vendosur në pikëpyetje sistemin demokratik brenda kësaj organizate pretendojnë që OBT-ja është vegël e grupeve të lobimit dhe që interesat komerciale të kompanive kanë prioritet mbi zhvillimin, mjedisin, sigurinë dhe shëndetin, duke shkatërruar në këtë mënyrë vendet e punës dhe duke dobësuar fuqinë e shtetit anëtar.

Në publikimin e OBT-së me titull “10 common misunderstanding about the WTO” jepen edhe përgjigjet e këtyre pikëpyetjeve të cilat janë paraqitur në lidhje me këtë organizatë. Sipas avokatëve të globalizimit dhe tregtisë së lirë, OBT-ja është organizatë e cila udhëhiqet nga shtetet anëtare pasi që parimet dhe rregullat e OBT-së derivohen si rezultat i negociatave mes shteteve anëtare. ⁶ Sa i takon tregtisë së lirë, me rregullat e këtij sistemi tentohet ulja e tarifave doganore dhe eliminimi i barrierave të tjera jodoganore, por kjo bëhet në mënyrë graduale me qëllim që të mos dëmtohet ekonomia e shtetit anëtar. Agjenda Doha për Zhvillim është një iniciativë e shteteve në zhvillim që dëshirojnë të përmirësojnë rregullat nga fusha e bujqësisë, që nënkupton që edhe shtetet e vogla kanë të drejtat e tyre në OBT dhe nuk janë edhe aq të pafuqishme. Vendimet në OBT merren me konsensus, ku çdonjëri nga shtetet ka të drejtën e fjalës e cila thuhet nëpërmjet përfaqësuesve shtetëror, kurse marrëveshjet shumëpalëshe ratifikohen nga ana e shteteve anëtare.⁷ Nëpërmjet Marrëveshjes së Marrakeshit shtetet i kushtuan një rëndësi të veçantë edhe shfrytëzimit optimal të resurseve dhe mbrojtjes së mjedisit

⁵ WTO, “10 things the WTO can do”, World Trade Organization, Geneva, 2012, fq 48

⁶ WTO, 10 common misunderstandings about the WTO, World Trade Organization, Geneva, 2008, fq. 2

⁷ Po aty, fq. 10

jetësor. Klauzolat kyçe të OBT-së iniciojnë që qeveritë të ndërmarrin veprime për mbrojtjen e njeriut, kafshëve, botës bimore dhe shëndetit. Rëndësi e veçantë u kushtohet prodhimeve me prejardhje nga kafshët dhe bimët, duke vendosur standarde të ushqimit në bashkëpunim me Organizatën për Ushqim dhe Bujqësi (FAO) dhe Organizatën Botërore të Shëndetësisë (WHO) nëpërmjet standartit *Codex Alimentarius*.⁸

Nuk ka dyshim në atë që shtetet e fuqishme më së shumti përfitojnë nga marrëveshjet dhe rregullat tregtare të OBT-së, por kjo nuk nënkupton që shtetet në zhvillim dhe ato më pak të zhvilluara mbesin jashtë përfitimeve. Shtetet me ekonomi më të fuqishme janë ato që më së shumti kontribuojnë në buxhetin e OBT-së, andaj është më se normale që influenza e tyre të jetë më e madhe. Shtetet në zhvillim ballafaqohen edhe me shumë probleme të tjera siç janë liberalizimi i çmimeve, privatizimi, ristrukturimi, stabilizimi ekonomik i vendit⁹, andaj edhe përfitimet nga OBT-ja në fillimet e anëtarësimit do të jenë më të vogla. Sipas Paul R. Krugman gati asnjë shtet nuk merr pjesë në tregtinë plotësisht të lirë, me përjashtim të Hong Kongut që zhvillon politika të ndara ekonomike nga Kina dhe ndoshta është ekonomia e vetme bashkëkohore pa doganë dhe kuota të importit.¹⁰ Tregtia e lirë është një sfidë për të gjitha shtetet pa dallim fuqisë së tyre ekonomike. Shtetet me një zhvillim më të ulët teknologjik frikësohen nga hapja e ekonomive ndaj tregut ndërkombëtar duke menduar që industritë e tyre nuk do të mund t'u konkurrojnë në aspektin tregtar industrive të huaja. Nga ana tjetër, banorët e shteteve të cilat janë teknologjikisht të zhvilluara, ku punëtorët fitojnë mëditje të mëdha, frikësohen që tregtia e lirë, sidomos me shtetet më pak të zhvilluara do të ndikojë negativisht në standardin e tyre jetësor.

2. Anëtarësimi i Maqedonisë në OBT

Shkatërrimi i strukturave të pushtetit komunist në shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore, duke nisur nga ndryshimi i sistemit në ish-Bashkimin Sovjetik i nisur nga ana e Mihail Gorbaçovit, ndikoi që të përmbysen edhe sistemet social-komuniste të pjesës lindore të Evropës, duke ja hapur kështu rrugën demokracisë dhe ekonomisë së tregut. Pas stabilizimit politik të shteteve të ish-Jugosllavisë dhe BRSS-së, nisi edhe funksionimi i ekonomisë së tregut dhe integrimi i vendeve në ekonominë botërore. *“Qeveria e Republikës së Maqedonisë trashëgoi nga Jugosllavia e dikurshme një kuotë të lartë inflacioni. Megjithatë pas shpalljes së pavarësisë janë shënuar sukseset e para në stabilizimin ekonomik”*.¹¹ Faza e tranzicionit të Maqedonisë mes tjerash përfshinte edhe integrimin e shtetit në organizatat ndërkombëtare dhe aleancat euro-atlantike. Të gjitha reformat të cilat realizoheshin nga qeveritë përkatëse kishin për qëllim plotësimin e standardeve të cilat vendoseshin si kushte për anëtarësim. Reformat nga fusha e

⁸WTO, 10 common misunderstandings about the WTO, World Trade Organization, Geneva, 2008, f. 6

⁹ Niko Ketri, *Ekonomia Politike*, UFO Press, Tiranë 2008, f. 315

¹⁰ Paul R. Krugman & Maurice Obstfeld, *Ekonomia Ndërkombëtare (Teoria dhe politika ekonomike)*, Kolegji Victory, Prishtinë, 2010

¹¹ Vernet Vajdenfeld, *Demokracia dhe Ekonomia e Tregut në Evropën Lindore – Strategji për Evropën*, Shtëpia e Librit & Fondacioni Soror, Tiranë, 1999

ekonomisë dhe tregtisë kanë pasur për qëllim liberalizimin e tregut, dhe mbi të gjitha kanë qenë kusht i domosdoshëm për anëtarësim në OBT.

Sot, OBT-ja numëron gjithsej 161 shtete anëtare dhe 23 shtete të cilat janë në nivel të vëzhguesit. Nga vendet e rajonit Shqipëria, Maqedonia, Greqia, Mali i Zi dhe Bullgaria janë shtete anëtare të OBT-së, kurse Serbia dhe Bosnja Hercegovina janë shtete vëzhguese të cilat janë në pritje të anëtarësimit të plotë. Sa i takon Kosovës, akoma nuk është marrë ndonjë qëndrim konkret nga institucionet përkatëse dhe qeveria e Kosovës, për anëtarësim në OBT apo për aplikim në rolin e vëzhguesit. Maqedonia është anëtare e plotë i OBT-së qysh prej 4 Prillit të vitit 2003 dhe është e pranuar si FYROM (Former Yugoslav Republic of Macedonia).

Qeveria e Maqedonisë ka aplikuar për anëtarësim në OBT në dhjetor të vitit 1994 duke dorëzuar Memorandumin e Regjimit të Tregtisë së Jashtme. Në takimin e Komitetit Përgatitor në 21 Dhjetor u themelua *grupi punues* për të shqyrtuar kërkesën e qeverisë së Maqedonisë për t'u anëtarësuar në OBT. Sipas Raportit të Grupit Punues për anëtarësim të Maqedonisë në OBT, *grupi punues* ka pasur takime në 10 Korrik 2000, 15 Mars dhe 7 Dhjetor 2001, dhe 23 Maj dhe 17 Shtator 2002.¹² Në pjesën hyrëse të raportit Maqedonia përshkruhet si një vend që ka pasur trazira të vazhdueshme politike dhe ekonomike, si dhe konflikte në rajon qysh prej vitit 1991. Sipas të njëjtit raport, Maqedonia kishte humbur tregjet e saja tradicionale dhe kishte shënuar një rënie të madhe në investimet e huaja direkte. Procesi i privatizimit ka pasur një progres substancial, ku numri i kompanive të privatizuara në fillimet e viteve 2000 kishte arritur 90%. Raporti përmban edhe të dhënat për politikën ekonomike të qeverisë, përfshirë ato monetare dhe fiskale. Sa u takon investimeve të huaja, përfaqësuesit e Maqedonisë në *grupin punues* e kanë përshkruar si një treg të lirë me të drejtë sipërmarrjeje dhe mbrojtje ligjore të pronës, gjë që garantohet edhe me Kushtetutë, parime këto të cilat mund të kufizohen veçse me ligjin për çështje të sigurisë kombëtare, mbrojtje të ambientit jetësor dhe jetës njerëzore. Investimet të huaja në Maqedoni janë të rregulluara me Ligjin për Kompanitë Tregtare të shpallur në Gazetën Zyrtare nr. 28/96.¹³

Raporti në vazhdim përmban politikën e çmimeve, konkurrencës, pronës shtetërore dhe privatizimit. Sa u takon çmimeve në Raport përshkruhen si çmime të rregulluara nga tregu, kurse konkurrenca lojale është e garantuar me ligj me përjashtim të disa sektorëve të cilat mbrohen po ashtu me ligj. Pjesë më e madhe e raportit përmban të dhëna për Regjimin e Tregtisë së Jashtme të Maqedonisë, përfshirë politikën e importit dhe eksportit, tarifën doganore, masat dhe barrierat e tjera jodoganore, e kështu me radhë.

Negociatat e *grupit punues* mbaruan diku nga Shtatori i vitit 2002, kurse vendimi nga Këshilli i Përgjithshëm me 2/3 e votave u morr më 15 Tetor 2002. Në mars të vitit 2003 qeveria e Maqedonisë mbaroi procesin e ratifikimit dhe pranimit të Protokollit të Anëtarësimit, kurse 30

¹² WTO, Report of the working party on the accession of the Former Yugoslav Republic of Macedonia, WTO, September, 2002

¹³ Службен Весник на Република Македонија бр.28, 6 Јуни, 1996 година

ditë pas ratifikimit Maqedonia u bë pjesë anëtare e OBT-së.¹⁴ Dekreti I ligjit për ratifikimin e Protokollit për anëtarësim të Maqedonisë në OBT u shpall në Gazetën Zyrtare 7/2003 në pjesën e marrëveshjeve ndërkombëtare.¹⁵ Protokollin e Anëtarësimit të Maqedonisë ishte i përbërë nga Hyrja, Pjesa e Përgjithshme, Afatet dhe Dispozitat përfundimtare. Dokumenti përfundimtar është i shkruar nga një kopje në tre gjuhët dhe atë: anglisht, frëngjisht dhe spanjisht.

3. Përfitimet dhe kostot e Maqedonisë nga anëtarësimi në OBT

Si çdo shtet tjetër po ashtu edhe Maqedonia është ballafaquar me sfida dhe kosto gjatë periudhës së procesit të anëtarësimit në OBT dhe më pas. Duke marrë parasysh faktin që Maqedonia është një shtet i shkëputur nga Republika e Jugosllavisë, periudha e tranzicionit politik, ekonomik dhe social është shoqëruar me një kosto relativisht të lartë. Edhe anëtarësimi në OBT ka pasur kosto duke nisur nga përgatitja e Memorandumit të Regjimit të Tregtisë së Jashtme, ulja e të ardhurave nga doganat, atakimi i bizneseve vendase nga konkurrenca e jashtme, ndryshimet legjislative nga fusha e tregtisë dhe ekonomisë, kostot e institucionalizimit, trajnimit të kuadrit përkatës me rregullat të reja, e kështu me radhë. Të ardhurat nga doganat janë pjesë përbërëse e buxhetit shtetëror, andaj ulja e tarifave doganore do të rezultojë me uljen e të ardhurave të përgjithshme të buxhetit. Kjo është njëra anë e medaljes, kurse ana tjetër është se tarifave doganore e vendosur mbi mallin e importuar nënkupton një kosto më të lartë për konsumatorët e atij produkti ose shërbimi. Tarifa doganore rrit çmimin final të produktit, kështu që blerësit final do të jenë të detyruar të paguajnë më shumë për mallrat dhe shërbimet e dëshiruara. Gjithashtu tarifat e larta doganore ndikojnë në uljen e importeve në vend apo hapin rrugët e kontrabandës. Personat apo kompanitë që merren me import të produkteve do të përdorin rrugët ilegale që të kalojnë kufijtë dhe t'i plasojnë ato në tregun e brendshëm. Liberalizimi i tregtisë mbyll këta rrugë duke mundësuar që mallrat të kalojnë procedurat doganore me tarifa të ulëta dhe të kenë plotësuar standardet sanitare dhe fitosanitare. Sa i takon atakimit të bizneseve vendase nga konkurrenca e jashtme, Maqedonia ka bërë një plan detal për mbrojtjen e industrive të cilat kanë qenë të rrezikuara me kuota të cilat lejohen sipas parimeve të OBT-së. Sipas Darinka Panovska, këshilltare në sektorin për marrëveshje tregtare të mallrave të OBT-së në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë të Maqedonisë, të gjitha kompanitë kanë qenë të informuar mbi parimet dhe rregullat e OBT-së, e kjo ka ndodhur duke shkruar qytet në qytet.¹⁶ Kjo listë e mbrojtjes së prodhimeve vendase është prezantuar edhe para organeve të OBT-së gjatë periudhës së negociatave bilaterale të anëtarësimit para *grupit punues*, gjë që është aprovuar nga ana e shteteve pjesëmarrëse. Sa i takon kostos së përgatitjes së Memorandumit, një ndihmë është ofruar edhe nga ana e Sekretariatit të OBT-së, kurse një pjesë e shpenzimeve për të paguar kuadrin e angazhuar dhe institucionet përkatëse është mbuluar nga buxheti i Maqedonisë. Gjatë procesit të negociatave nga ana e OBT-së ofrohen trajnime për aplikimin e rregullave dhe marrëveshjeve të OBT-së, gjë që ka ndarë koston e përgjithshme të institucionalizimit dhe

¹⁴ WTO, Accession of the Former Yugoslav Republic of Macedonia, WTO, October, 2002

¹⁵ Службен Весник на Република Македонија бр.7, 2 Февруари, 2003 година

¹⁶ Darinka Panovska, Intervistë Personale, dt. 3 Mars 2015, Shkup

trajnimin të kuadrit përkatës. Këto ishin shkurtimisht kostot me të cilat është ballafaquar Maqedonia gjatë anëtarësimit në OBT, kosto të cilat në krahasim me përfitimet dhe mundësitë janë minimale.

Në vitin 2013 Sekretariati i OBT-së ka lëshuar raportin për ecurinë 10-vjeçare të Maqedonisë në aspekt të liberalizimit të tregut dhe uljen graduale të tarifave doganore. Në pjesën hyrëse të këtij raporti shkruhet: *“Republika Ish-Jugosllave e Maqedonisë, një vend i vogël pa bregdet me diku 2 milion banorë dhe GDP prej 10 miliardë dollarë amerikanë, ka hapur tregun, me eksport dhe import të mallrave dhe shërbimeve prej 127% të GDP-së në vitin 2012. Pavarësisht disavantazheve të trashëguara, me kapacitet resursesh të vogla dhe të kufizuara, qeveria ka krijuar dhe mirëmbajtur kornizën e politikave dhe ka pasur sukses në disa fusha: nxitjen e rritjes, stabilitet makroekonomik dhe financiar përballë goditjeve të jashtme, duke bërë reforma për anëtarësim në BE dhe duke lehtësuar eksportin e produkteve maqedonase në tregjet e BE-së; duke lehtësuar qasjen e tregjeve të tjera të rëndësishme nëpërmjet anëtarësimit në OBT, duke nënshkruar marrëveshje për tregti të lirë; si dhe duke përmirësuar mjedisin e biznesit për të tërhequr investimet e huaja direkte.”*¹⁷ Sipas të njëjtit raport në pjesën për kornizën e politikave tregtare, thuhet që Maqedonia është e orientuar fuqishëm drejt partnerëve me të cilat ka nënshkruar marrëveshje për tregti të lirë, dhe që diku 90% e eksporteve të Maqedonisë dhe 80% të importeve rregullohen me FTA (Marrëveshjet për Tregti të Lirë), me vendet e BE-së diku 63% në eksport dhe 58% në import. Diku 80% e tregtisë është e lirë nga tarifatat doganore dhe 7% me tarifa doganore preferenciale.¹⁸ Sipas Snezhana Nikolovskës, këshilltare në sektorin për marrëveshje tregtare të shërbimeve në OBT në Ministrinë e Ekonomisë të Maqedonisë, *“... ligjet e Maqedonisë janë veçse më liberale në raport me kërkesat e anëtarësimit në OBT në sektorin e shërbimeve. Sipas radhitjes së përzgjedhur të shërbimeve, nga 120 shërbime, Maqedonia ka liberalizuar 115 prej tyre. Sektorët të shërbimeve që akoma mbrohen në përgjithësi kanë të bëjnë me shërbimet bankare dhe financiare, dhe këto me kufizime të caktuara.”*¹⁹ Pra në bazë të raporteve të OBT-së dhe vlerësimeve të personave kompetent të cilat merren me çështjen e marrëveshjeve shumëpalëshe të OBT-së, Maqedonia është veçse një treg i lirë, si në sektorin e mallrave, po ashtu edhe në sektorin e shërbimeve.

¹⁷ WTO, Trade Policy Review: Report by the Secretariat for FYROM, Trade Policy Review Body, October, 2013 f. 6

¹⁸ Po aty, f. 7

¹⁹ Snezhana Nikolovska, Intervistë Personale, dt. 3 Mars 2015, Shkup


Tabela 1: Mbulimi i importit me eksport në periudhën 2002-2014

Viti	Eksporti vlera në \$	Import vlera në \$	Deficiti tregtar vlera në \$	Mbulimi i importit me eksport
2002	1115526926	1995155885	-879628959	56
2003	1366988742	2306353206	-939364464	59
2004	1675877228	2931626088	-1255748860	57
2005	2042295799	3232837357	-1190541558	63
2006	2415160898	3752256230	-1337095332	64
2007	3398268282	5280584019	-1882315737	64
2008	3990642488	6882653384	-2892010896	58
2009	2708487570	5072820972	-2364333402	53
2010	3351429481	5474484884	-2123055403	61
2011	4478313344	7027162308	-2548848964	64
2012	4015416864	6522387659	-2506970795	62
2013	4298771673	6619586359	-2320814686	65
2014	4933844549	7276729202	-2342884653	68

Burimi: Државен Завод за Статистика, Скопје, 2015: Податоци од мак датабаза

Nga Tabela 1 mund që të konkludojmë që vlera e importit dhe eksportit të Maqedonisë, pas anëtarësimit të shtetit në OBT në vitin 2003 është pesëfishuar. Në vitin 2002 vlera e eksportit kap vlerën e diku 1.1 miliardë dollarëve amerikanë, në krahasim me vitin 2014 ku vlera e eksportit është diku 5 miliardë dollarë amerikanë. Nëse e marrim për bazë vitin 2003, në vitin 2014 kemi një rritje të eksportit prej 72%, kurse prej vitit në vit ka rritje të eksportit dhe importit. Edhe pse deficiti tregtar është pothuajse në të njëjtin nivel dhe kjo ka ndikim negativ në Bruto Produktin Vendor, kjo nuk nënkupton një rënie të GDP-së si përqindje. Mallrat dhe shërbimet e importuara mund të destinohen edhe si mallra për përpunim nga kompanitë vendore, gjë që ndikon në rritjen e prodhimit të brendshëm. Në figurën e mëposhtme jepet paraqitja grafike e lëvizjes së vlerave të eksportit dhe importit në periudhën 2002-2014.

Figura 1: Eksporti dhe importi në periudhën 2002-2014



Rritja e vlerave të eksportit dhe importit është përfitim i Maqedonisë pikërisht nga anëtarësi në BE. Çështja e Maqedonisë dhe tregjet evropiane dhe ato ndërkombëtare ka mundësuar që produktet e prodhuara brenda Maqedonisë të plasohen në tregjet evropiane dhe ato ndërkombëtare, kurse nga shtetet e tjera të importohen ato produkte dhe shërbime të cilat kanë qenë deficitare dhe të nevojshme për tregun e brendshëm. Në vitin 2013 sipas të dhënave nga Enti Statistikor i Maqedonisë, Maqedonia më së shumti eksporton në vendet e BE-së diku në vlerën prej 3.1 miliardë dollarëve amerikanë, prej të cilave 1.5 miliardë eksport drejt Gjermanisë. Sa u takon vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe anëtare të CEFTA-s, Maqedonia eksporton mallra dhe shërbime në vlerë prej 751 milion dollarëve, nga ku diku 276 milion dollarë janë eksporte drejt Kosovës dhe 269 milion drejt Serbisë. Importuesit më të mëdhenj për vitin 2013 janë përsëri vendet e BE-së me vlerë prej 4.1 miliardë dollarë, nga ku vlera më të mëdha shënojnë Britania e Madhe (726 milionë \$), Gjermania (693 milionë \$), Greqia (697 milionë \$) dhe Italia (428 milionë \$), kurse nga vendet e Ballkanit Perëndimor e para renditet Serbia e cila importon në Maqedoni në vlerën prej diku 380 milionë dollarëve.²⁰

Tabela 2: Pjesëmarrja e importit dhe eksportit të mallrave dhe shërbimeve në GDP

	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Deficiti tregtar në mallra	-19.2	-20.1	-26.3	-23.3	-20.5	-22.3	-23.8
Eksport mallrash	36.8	41.6	40.5	29.0	35.8	42.4	41.1
Import mallrash	-56.0	-61.6	-66.8	-52.3	-56.4	-64.8	-64.9
Balanci në shërbime	0.3	0.5	0.1	0.2	0.5	1.3	0.3
Eksport shërbimesh	9.2	10.0	10.3	9.2	9.7	10.7	11.0
Import shërbimesh	-8.8	-9.5	-10.2	-9.0	-9.1	-9.4	-10.7

Burimi: Trade Policy Review: Report by the Secretariat for FYROM, f. 12

Nga Tabela 2 konkludojmë që pjesëmarrja e eksportit dhe importit të mallrave në GDP-në e Maqedonisë është e madhe. Në krahasim me vitin 2009 ku për shkak të krizës financiare pjesëmarrja e eksportit është 29.0%, në vitin 2011 arrin edhe vlerën maksimale prej 42.4%. Për dallim nga diferenca negative në llogarinë e eksport-importit të mallrave, Maqedonia shënon suficitit në shifra të vogla në sektorin e shërbimeve. Pjesëmarrja e eksportit të shërbimeve në GDP në vitin 2012 ka qenë me 11.0%, kurse në vitin 2011 kemi edhe përqindjen më të lartë të suficitit në sektorin e shërbimeve. Nga vlera totale e eksporteve për vitin 2012, 3.1 miliardë

²⁰ Државен Завод за статистика на РМ, Статистички годишник на РМ, 2014

dollarë janë mallra, kurse 828.9 milion dollarë janë shërbime. Sa i takon importit nga vlera totale, në vitin 2012, 5.1 miliardë dollarë janë vlera e mallrave, kurse vetëm se 806.3 milionë dollarë janë shërbime.²¹

Sa u takon Investimeve të Huaja Direkte (IHD), sipas Raportit për Vlerësimin e Politikave nga OBT-ja, ata kanë qenë shumë të ulëta deri në vitin 1998. Në periudhën 1998-2006 pas hovit të privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore dhe blerjen e bankave dhe kompanive gjigante nga ana e investitorëve të huaj, vlera më e madhe e investimeve të huaja regjistrohet në vitin 2007 me diku 506 milion euro, nga ku 67% në sektorin e shërbimeve. Investimi më i madh I huaj llogaritet shitja e operatorit të telekomunikacionit Telekomit Hungarez. Në vitin 2012 vlera totale e IHD ka qenë 104.8 milion euro.²²

Shkurtimisht këta janë disa nga përfitimet ekonomike në nivel shtetëror që ka pasur Maqedonia pas anëtarësimit në OBT. Edhe pse Maqedonia nuk ka pasur akoma asnjë konflikt me ndonjë shtet tjetër të paraqitur në Panelin për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve në kuadër të OBT-së, ekzistimi i këtij organi është një përfitim potencial për të ardhmen. SHBA-ja është shteti më me shumë padi dhe ankesa. Në periudhën 1995-2013, SHBA-ja është paditur gjithsej 121 herë, kurse ka lëshuar 106 ankesa. Nga shtetet e rajonit gjatë kësaj periudhe, Greqia është paditur 3 herë dhe Kroacia 1 herë.²³

Përfitimet e kompanive nga rregullat dhe parimet e OBT-së fokusohen kryesisht në kompanitë të cilat kanë kapacitet eksportues dhe firmave tregtare të cilat importojnë mallra nga jashtë vendit. Edhe pse nga njëra anë rritet niveli i konkurrencës në sektorin e mallrave dhe shërbimeve, liberalizimi i tregtisë është një mjet për luftimin e firmave monopoliste të cilat pasurohen në kurriz të konsumatorëve. Rregullat e OBT-së gjithashtu u imponojnë kompanive që të aplikojnë masat dhe standardet e prodhimit, pjesë kjo e Marrëveshjes për Masat Sanitare dhe Fitosanitare. Rritja e kualitetit të prodhimit dhe ulja e çmimeve nuk nënkupton gjithmonë humbje për kompanitë dhe industrinë vendase. Kompanitë vendase të cilat nuk kanë mundësi që prodhimet e tyre të shesin në tregun e brendshëm, u mundësohet që ato të plasojnë në tregun ndërkombëtar, duke rritur në këtë mënyrë fitimin e tyre dhe duke mbushur arkën shtetërore nga tatimet. Kompanitë të cilat zgjerohen në tregjet e huaja do të kenë nevojë për fuqi punëtore, me ç'rast liberalizimi i tregtisë ndikon edhe në uljen e normës së papunësisë. Shumë kompani të cilat merren me prodhimin e materialeve ndërtimore në Maqedoni eksportojnë produkte edhe në vendet e BE-së dhe më gjerë. Veçse në Maqedoninë Perëndimore janë dy kompani gjigante si Knauf dhe Renova, që jo vetëm që furnizojnë tregun e brendshëm me materiale ndërtimore, por të njëjtat i shesin edhe në tregjet e vendeve fqinje dhe ato evropiane. Edhe firmat tregtare të cilat importojnë mallra nga jashtë përfitojnë pasi që kanë mundësi që të shesin mallra me çmime më

²¹ WTO, Trade Policy Review: Report by the Secretariat for FYROM, Trade Policy Review Body, October, 2013, f. 15,16 dhe 17

²² Po aty, f. 18

²³ WTO, Annual Report 2014, WTO Secretariat, Geneva, 2014, f. 90

të favorshme dhe kualitative. Përderisa para anëtarësimit tarifata doganore në materialet ndërtimore lëviznin prej 15-10%, sot firmat tregtare i importojnë këto mallra duke paguar vetëm se 1% doganë si dhe shpenzimet e ulëta administrative doganore.

Gjithashtu edhe konsumatorët përfitojnë nga anëtarësimi i shtetit në OBT. Përfitimet në nivel të konsumatorit kanë të bëjnë me zgjerimin e zgjedhjes konsumatore dhe uljen e kostos së jetesës. Me importimin e produkteve dhe shërbimeve, konsumatorit final i ofrohet një gamë më e gjerë e produkteve dhe shërbimeve, qofshin ato të një kualiteti të lartë dhe luksoz, qofshin ato produkte të cilat vendi amë nuk është në gjendje ti prodhojë. Sot p.sh. në vend që njerëzit të ngasin veturat Yugo ose Zastava, që ishin modele të vetme të automobilave në kohën e sistemit të ish-Jugosllavisë, tregu ynë është i stërbushur me një llojllojshmëri të automjeteve duke filluar nga markat më të njohura si Wolsvagen, Mercedes, BMW, Porche, e deri tek markat më pak të njohura. Sot konsumatori i Maqedonisë mund që të kalojë një pushim të këndshëm në qendrat tregtare të hapura në Shkup dhe Tetovë, si dhe mund të blejë ato ushqime dhe veshmbathje të cilat i ka për shije. Firmat e njohura të veshmbathjeve të njohura botërisht si: Adidas, Nike, Dolge Gabana, Cotton, mund që t'i gjeshe edhe në Maqedoni, me produkte të po të njëjtit kualitet sikurse edhe në vendet e tjera të zhvilluara. Pra me një fjalë, liberalizimi i tregtisë i mundëson konsumatorit që të konsumojë atë që dëshiron dhe të vishet sipas shijes së tij personale.

Përfitimi i dytë në këtë nivel ka të bëjë me uljen e kostos së jetesës. Përderisa në të kaluarën një bisedë telefonike kushtonte aq shumë sa që shtresa e ulët nuk mund të shfrytëzonte këtë shërbim, sot me hapjen e tregjeve bisedat telefonike qofshin nga ato fikse apo celular janë relativisht të ulëta, e gjithë kjo falë rritjes së konkurrencës. Gjithashtu fëmijët mund që të blejnë lodrat e tyre të ëndrrave të cilat importohen nga Kina me çmime mjaft të ulëta, edhe pse ndoshta kualiteti nuk është edhe aq i lartë. Edhe sa i takon sektorit të tekstilit, sot në tregun e Maqedonisë mund të gjeshe produkte me çmime mjaft të ulëta. Vetëm se në qytetin e Dibrës janë disa shitore ku mund të blesh veshje me çmime që nisin prej 220 denarë e më lartë.

Përfundim

Nga e gjithë kjo që u trajtua në këtë punim hulumtues vijmë në konkludimin që përfitimet nga tregtia e lirë janë shumë më të mëdha se sa përfitimet e shteteve të cilat aplikojnë politika proteksioniste dhe ekonomi të mbyllur. Maqedonia pas shpërbërjes së sistemit të Ish Jugosllavisë, vendosi që të zgjedhë sistemin demokratik dhe ekonominë e tregut. Reformat e fazës së tranzicionit përfshijnë shumë fusha edhe atë : liberalizimin e tregut dhe çmimeve, privatizimin e pronës shtetërore, reformat fiskale dhe financiare, e kështu me radhë. Një rëndësi e veçantë iu kushtua edhe anëtarësimit të vendit në organizatat ndërkombëtare, përfshirë këtu edhe OBT-në. Pas aplikimit për anëtarësim në vitin 1994, qeveria e Maqedonisë iu desh që të përmbushte të gjitha kërkesat dhe detyrimet të cilat ishin pjesë e Protokollit të Pranimet në OBT. Gjatë kësaj periudhe kishte kosto dhe sfida, të cilat në krahasim me përfitimet janë pothuajse minimale. Edhe pse Maqedonia ballafaqohet me një krizë politike dhe ekonomike të brendshme, treguesit

makroekonomik dhe treguesit e tregtisë së jashtme janë pozitive. Sipas Raportit të OBT-së, Maqedonia veçse është një treg i lirë, me tarifa doganore pothuajse minimale dhe me një rritje ekonomike të qëndrueshme. Shteti ka përfituar nga anëtarësimi në OBT në aspekt të rritjes së vlerave të importit dhe eksportit, si dhe nga depërtimi i IHD-së. Gjithashtu nga ky anëtarësim kanë përfituar edhe firmat tregtare të cilat importojnë mallra nga jashtë, kompanitë të cilat kanë kapacitet eksportues për tregjet e jashtme dhe konsumatorët të cilët blejnë produkte me çmime më të lira dhe më kualitative. Ajo çka nevojitet të bëjë qeveria e Maqedonisë është angazhimi në zgjidhjen e çështjes së emrit që i është vendosur si kush për anëtarësim në BE, me ç'rast bëhet pjesë e tregut të përbashkët evropian. Gjithashtu nevojiten reforma edhe në fushën e thithjes së investimeve të huaja. Duke marrë parasysh që vlera e investimeve të huaja në vitin 2012 ka qenë e ulët, kjo nënkupton që investitorët të huaj nuk shohin akoma një stabilitet politik dhe ekonomik që të hapin kompani në Maqedoni. Sigurimi i kapitalit të huaj dhe zgjidhja e krizës së brendshme padyshim që do tu hapte rrugën investitorëve të huaj për të investuar kapitalin e tyre në këtë vend.

Referencat

- Natalie Goldestein, Globalization and Free Trade, Infobase Publishing, New York, 2007
- Richard E.Caves & Jeffrey A.Frankel & Ronald W.Jones, Tregtia Botërore dhe Pagesat, Ars Lamina, Shkup, 2013
- Niko Ketri, Ekonomia Politike, UFO Press, Tiranë 2008, f. 315
- Paul R. Krugman & Maurice Obstfeld, Ekonomia Ndërkombëtare (Teoria dhe politika ekonomike), Kolegji Victory, Prishtinë, 2010
- Vernet Vajdenfeld, Demokracia dhe Ekonomia e Tregut në Evropën Lindore – Strategji për Evropën, Shtëpia e Librit & Fondacioni Soros, Tiranë, 1999
- WTO, “10 things the WTO can do”, World Trade Organization, Geneva, 2012
- WTO, 10 common misunderstandings about the WTO, World Trade Organization, Geneva, 2008
- WTO, Understanding the WTO, World Trade Organization, Geneva, 2011
- WTO, Report of the working party on the accession of the former Yugoslav Republic of Macedonia, WTO, September, 2002
- WTO, Accession of the Former Yugoslav Republic of Macedonia, WTO, October, 2002
- WTO, Trade Policy Review: Report by the Secretariat for FYROM, Trade Policy Review Body, October, 2013
- WTO, Annual Report 2014, WTO Secretariat, Geneva, 2014
- Службен Весник на Република Македонија бр.28, 6 Јуни, 1996 година
- Службен Весник на Република Македонија бр.7, 2 Февруари, 2003 година
- Darinka Panovska, Intervistë Personale, dt. 3 Mars 2015, Shkup
- Snezhana Nikolovska, Intervistë Personale, dt. 3 Mars 2015, Shkup
- Државен Завод за статистика на РМ, Статистички годишник на РМ, 2014
- Државен Завод за Статистика, Скопје, 2015: Податоци од мак база

